

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Raporti vjetor për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal
2020-2030

(Periudha: Janar 2025 - Dhjetor 2025)

Prishtinë 2026

Hyrje

Strategjia për Zhvillim Rajonal (2020–2030) është dokumenti kryesor strategjik i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i cili synon zhvillimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të të gjitha rajoneve të vendit. Përmes kësaj strategjie synohet zvogëlimi i dallimeve dhe pabarazive ndërmjet rajoneve, duke krijuar mundësi të barabarta për zhvillim ekonomik dhe social, në përputhje me parimet e politikës evropiane të zhvillimit gjithëpërfshirës.

Kjo strategji përcakton objektivat dhe prioritetet afatgjata të politikës së zhvillimit rajonal për periudhën dhjetë vjeçare 2020–2030 dhe njëkohësisht mundëson koordinimin e politikave sektoriale në nivel rajonal. Ajo ndihmon në harmonizimin e prioritetëve zhvillimore ndërmjet institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm, duke krijuar një qasje të përbashkët për zhvillimin e rajoneve.

Përveç orientimeve strategjike afatgjata, strategjia përcakton edhe prioritetet kryesore të Qeverisë në afat të mesëm, me fokus në zhvillimin ekonomik, social dhe territorial të rajoneve zhvillimore.

Me qëllim të monitorimit të zbatimit të strategjisë, Ministria e Zhvillimit Rajonal harton raporte periodike monitoruese, në të cilat përfshihen aktivitetet e institucioneve sektoriale, komunave, organizatave joqeveritare dhe vetë ministrisë. Këto raporte pasqyrojnë nivelin e realizimit të aktivitetëve dhe progresin e arritur në përmbushjen e objektivave të përcaktuara në strategji.

Raporti shërben si një mekanizëm i rëndësishëm për Qeverinë dhe institucionet përgjegjëse, duke ofruar një pasqyrë të qartë mbi nivelin e zbatimit të strategjisë dhe nevojën eventuale për riorientim të politikave zhvillimore. Njëkohësisht, informon organizatat joqeveritare, partnerët ndërkombëtarë dhe palët e tjera të interesuara mbi progresin e arritur në fushën e zhvillimit rajonal dhe ndihmon në përcaktimin e prioritetëve për periudhat e ardhshme.

MEKANIZMAT INSTITUCIONAL PËR MONITORIM

Me qëllim që zbatimi i Strategjisë për Zhvillim Rajonal të përcillet në mënyrë të rregullt dhe efektive, Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR), si institucioni përgjegjës për monitorimin e saj, përmes Planit të Veprimit ka përcaktuar aktivitete konkrete, afate kohore dhe indikatorë për realizimin e objektivave të strategjisë. Duke qenë se Strategjia për Zhvillim Rajonal përfshin shumë sektorë, në proces janë përfshirë edhe institucionet tjera përgjegjëse dhe mbështetëse, të cilat kontribuojnë në arritjen e objektivave të përcaktuara nga Qeveria.

Për të pasur një pasqyrë sa më të qartë mbi progresin e arritur dhe sfidat gjatë zbatimit të strategjisë, MZHR përgatit raporte periodike që reflektojnë realizimin e aktivitetëve dhe ecurinë e Planit të Implementimit të Strategjisë për Zhvillim Rajonal.

Në kuadër të mandatit të saj dhe me mbështetjen e projektit të UN-HABITAT për shërbime të qëndrueshme komunale, MZHR ka koordinuar procesin e krijimit të mekanizmit monitorues

për zbatimin e strategjisë. Gjatë këtij procesi janë përcaktuar përgjegjësitë e institucioneve në nivel qendror dhe lokal, si dhe roli i shoqërisë civile në mbështetje të procesit të implementimit.

Në funksion të evidentimit të progresit të arritur nga aktivitetet e parapara në strategji, MZHR ka hartuar raportin njëvjeçar të implementimit të Strategjisë për vitin 2025. Ky raport synon të paraqesë aktivitetet dhe rezultatet e arritura, si dhe të identifikojë sfidat dhe hapat e nevojshëm për adresimin e tyre, me qëllim të avancimit të zhvillimit rajonal në përputhje me prioritetet e Qeverisë.

Gjithashtu, për të siguruar koordinim dhe bashkëpunim ndërinstitucional në monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal, MZHR, me Vendimin nr. 87, ka themeluar Grupin ndër-sektorial, i cili udhëheq dhe koordinon procesin e implementimit të strategjisë.

Në bazë të objektivave të caktuara dhe synimeve për zbatimin e Strategjisë për Zhvillim Rajonal 2020-2030, grupi ndër-sektorial për zbatimin e strategjisë është në përbërje të institucioneve, si vijon:

- Ministria e Zhvillimit Rajonal;
- Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Zyra e Kryeministrit
- Zyra për Planifikim Strategjik
- Ministria e Ekonomisë;
- Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Ministria për Komunitet dhe Kthim;
- Agjencia e Statistikave të Kosovës;
- Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Veri”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Jug”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Qendër”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Lindje”
- Agjensioni Zhvillimor Rajonal “Perëndim”

Grupi Punues takohet në baza të rregullta dhe raporton në bazë periodike, sipas kërkesave të MZHR.

LISTA E SHKURTESAVE

MZHR	Ministria e Zhvillimit Rajonal
ZKM	Zyra e Kryeministrit
MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
MBPZHR	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
MMPHI	Ministria e Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
ME	Ministria e Ekonomisë
MKK	Ministria për Komunitet dhe Kthim
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
AZHR	Agjension për Zhvillimor Rajonal

OBJEKTIVAT STRATEGJIKE

Strategjia për Zhvillim Rajonal ka gjithsej tri objektiva:

Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal;

Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale;

Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.

Në kuadër të **Objektivi Strategjik: 1. Koordinimi i politikave për zhvillim rajonal**, me qëllim të realizimit të aktiviteteve konkrete, janë parashikuar dy objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 1.1 Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 1.2 Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.

Në **Objektivi Strategjik: 2. Zhvillimi rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale**, janë parashikuar edhe 4 objektiva specifike, si vijon:

Objektivi Specifik: 2.1 Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve;

Objektivi Specifik: 2.2 Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Objektiv Specifik: 2.3 Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Objektivi Specifik: 2.4 Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.

Në **Objektivi Strategjik: 3. Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.**, janë parashikuar edhe 3 objektiva specifike:

Objektivi Specifik: 3.1 Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;

Objektivi Specifik: 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve;

Objektiv Specifik: 3.4 Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.

Ndërsa, me qëllim të evidentimit të objektivave të strategjisë, janë vendosur synimet si vijon (të pasqyruara në tabelën 1), të cilat do të monitorohen dhe do të vlerësohen nga aspekti implementimit përmes planit të veprimit dhe raporteve monitoruese:

Synimet e përcaktuara për vitin 2025, për realizimin e objektivave strategjike të strategjisë për zhvillim rajonal	Vlera bazë 2020	Synimi 2024	Synimi 2025
Kornizë ligjore e përafuar me legjislacionin e BE-së, në fushën e zhvillimit rajonal			
Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	60%	100%
Themelimi i mekanizmave institucional për zhvillim rajonal, për hartimin monitorimin dhe vlerësimin e programeve/projekteve dhe performancës rajonale.	20%	100%	100%
Zhvillim rajonal i balancuar dhe rajone të afta për konkurrencë ndër rajonale			
Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në baze të vlerësimeve.	0%	15%	15%
Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	0%	17%	17%
Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonal përmes programeve trans nacionale.	0%	30%	30%
Arritja e niveleve më të larta të produktivitetit ekonomik përmes diversifikimit, përmirësimit teknologjik dhe inovacionit.	0%	25%	25%
Zhvillimi i qëndrueshëm rajonal bazuar në resurse natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane;			
Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane.	0%	45%	45%
Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve.	0%	20%	30%
Hartimi dhe zbatimi i politikave për promovimin e turizmit të qëndrueshëm që krijon vende pune dhe promovon kulturën, produktet lokale dhe rajonale.	0%	20%	30%
Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar.	0%	20%	30%

OBJEKTIV STRATEGJIK: 1. KOORDINIMI I POLITIKAVE PËR ZHVILLIM RAJONAL;

Objektivi Specifik 1.1. – Hartimi i legjislacionit primar dhe sekondar që rregullon fushëveprimin e mekanizmave për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi -1.1.1 Hartimi dhe miratimi i kornizës ligjore për zhvillim rajonal të balancuar ;

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministritë e linjë, Mbështetja nga donatorët: GIZ")

Pas realizimit të të gjitha aktiviteteve të përshkruara më parë, përfshirë analizat krahasimore, hartimin e dokumenteve strategjike, angazhimin e grupeve punuese ndër-sektoriale dhe zhvillimin e procesit të gjerë të konsultimeve me palët relevante, është arritur të finalizohet dhe të miratohet Ligji Nr. 08/L-190 për Zhvillim Rajonal të Balancuar si dhe aktet nenligjore të parapara me këtë ligj.

- Ligji NR.08/L-190 Për Zhvillim Rajonal të Balancuar
<https://mzhr.rks-gov.net/ligji/>

Ky ligj, së bashku me të gjitha aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, ka konsoliduar kornizën ligjore në këtë fushë, duke krijuar një bazë të qëndrueshme, funksionale dhe gjithëpërfshirëse për planifikimin, koordinimin dhe zbatimin efektiv të politikave të zhvillimit rajonal në Republikën e Kosovës.

- Rregullore për menaxhimin e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar
<https://mzhr.rks-gov.net/rregulloret/>
- Rregullore për themelimin, organizimin, funksionimin dhe monitorimin e Qendrave për zhvillim rajonal në rajonet zhvillimore.
<https://mzhr.rks-gov.net/rregulloret/>
- Rregullore për standardet, metodologjinë dhe sistemin e hartimit dhe monitorimit të Planeve Operacionale për zhvillim rajonal të rajonave zhvillimore.
<https://mzhr.rks-gov.net/rregulloret/>
- Rregullore për performancë rajonale dhe monitorim të zhvillimit socio - ekonomik rajonal të balancuar.
<https://mzhr.rks-gov.net/rregulloret/>

Veprimi- 1.1.5 Rishikimi dhe avancimi i dokumentit shpjegues për politikat e BE-së për zhvillim rajonal të balancuar 2025);

("Institucioni Kryesor: MZHR: Institucione mbështetëse: Ministritë e linjë, MFPT, ZKM, ASK, MMPH")

Departamenti për Integritet Evropian dhe Koordinim të Politikave ka përgatitur: Rishikimi dhe avancimi i dokumentit shpjegues për Politikat e BE-së, për zhvillim rajonal të balancuar me qëllim të ofrimit të një pasqyre të qartë dhe të përditësuar të kuadrit strategjik, objektivave dhe mekanizmave mbështetës të BE-së në këtë fushë. Pra, dokumenti në fjalë, synon të shërbejë si bazë orientuese për MZHR-n në procesin e planifikimit dhe zbatimit të politikave zhvillimore, si dhe për përputhjen e tyre me standardet dhe kërkesat evropiane.

- Dokumenti Shpjegues i Politikave Rajonale në Bashkimin Evropian

<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/77A7587A-7394-47AF-8EC9-F74E83D80752.pdf>

Objektivi specifik 1.2. -Themelimi i mekanizmave institucional për hartim, monitorim, dhe vlerësim të programeve/projekteve dhe performancës rajonale;

Veprimi- 1.2.2 Analiza mbi vlerësimin e fushave të nevojshme për investime me impakt rajonal; ("Institucioni Kryesor: MZHR, Komunitat")

Janë ndërmarrë të gjitha veprimet për krijimin e ekipeve, grupeve, sistemeve dhe mekanizmave për krijimin e databazave elektronike dhe gjenerimin e të dhënave sipas Rajoneve, Profileve/Sektoreve dhe specifikave tjera.

- Analiza në fushën e demografisë sipas shtatë rajoneve zhvillimore

<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/ANALIZA-NE-FUSHEN-E-DEMOGRAFISE-SIPAS-SHTATE-7-RAJONEVE-ZHVILLIMORE.pdf>

Veprimi- 1.2.3 Zhvillimi i sistemit për matjen e performancës rajonale; ("Institucioni Kryesor: MZHR, Komunitat")

Është zhvilluar sistemi për matjen e performancës rajonale. Është hartuar dhe miratuar Rregullorja (QRK) Nr.34/2024 për Performancë Rajonale dhe Monitorim të Zhvillimit Socio-Ekonomik Rajonal të Balancuar në dhjetor të 2024 dhe nga viti 2025 kemi filluar me analiza/raporte sipas fushave specifike të parapara në këtë rregullore.

- Rregullorja Nr.34/2024

<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/1f805d91-4452-4aec-90af-4f6b2cde5233.pdf>

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 2. ZHVILLIM RAJONAL I BALANCUAR DHE RAJONE TË AFTA PËR KONKURRENCË NDËR RAJONALE

Objektivi specifik 2.1 - Rritja e nivelit të zhvillimit socio-ekonomik të rajoneve, përmes përcaktimit të prioriteteve në bazë të vlerësimeve.

Veprimi - 2.1.2 Identifikimi i investimeve publike nga niveli qendror sipas rajoneve zhvillimore, zbërthyer edhe sipas komunave;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MAPL)

Gjatë vitit 2025, investimet kapitale në komuna janë zbatuar në kuadër të Masës 1: Mbështetje financiare për komunitat në investime kapitale, në kuadër të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027. Në këtë kuadër janë zbatuar si projektet e bartura nga viti 2024, ashtu edhe projektet e reja të miratuara gjatë vitit 2025.

Në vitin 2025 janë përzgjedhur gjithsej 16 projekte të reja, ndërsa numri i përgjithshëm i projekteve të zbatuara gjatë këtij viti (duke përfshirë edhe projektet e bartura) arrin në 30 projekte.

Shpërndarja e projekteve sipas rajoneve zhvillimore dhe komunave është si vijon:

- *Rajoni zhvillimor: 01 Qendër* – 3 projekte (Prishtinë dhe Podujevë (2))
 - *Rajoni zhvillimor: 02 Veri* – 5 projekte (Mitrovicë e Jugut (2), Vushtrri (2), Zubin Potok)
 - *Rajoni zhvillimor: 03 Perëndim* – 3 projekte (Deçan, Klinë (2))
 - *Rajoni zhvillimor: 04 Jug* – 6 projekte (Prizren (2), Suharekë, Mamushë (2), Dragash)
 - *Rajoni zhvillimor: 05 Jug-Lindje* – 4 projekte (Ferizaj, Shtime (2), Hani i Elezit)
 - *Rajoni zhvillimor: 06 Lindje* – 5 projekte (Gjilan, Novobërd, Kllokot, Kamenicë, Partesh)
 - *Rajoni zhvillimor: 07 Jug-Perëndim* – 4 projekte (Gjakovë, Rahovec (2), Junik).
- Raporti i zbatimit të Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale për vitin 2025
- <https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/838DC68B-AB0F-4DD3-B892-517A5E9B9823.pdf>

MAPL – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

MAPL për vitin 2025 ka realizuar 27 projekte nga programet si në vijim:

- ❖ Nga programi “Bashkëfinancimi me donatorë për skemën e granteve të bazuar në performancën komunale” janë realizuar 24 projekte. Mjetet e planifikuar për investime kapitale kanë qenë në vlerë prej 4,500,000.00 €, ndërsa është shpenzuar vlera prej 3,598,845.25 € ose 77.39%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:
- Vlerësimi i performancës së vitit 2023 për grantin e performancës komunale për vitin fiskal 2025.
- Marrëveshjet për mbështetje financiare janë nënshkruar për komunat përfituese nga Granti i performancës me datën 18.03.2025.
- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 19.06.2025, për shkak të zbatimit të ligjit me Nr. 08/L- 332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 konkretisht neni 14 - Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat.

Marrëveshja për mbështetje financiare përcaktojnë obligimet e palëve nënshkruese sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

- ❖ Nga programi “Programi komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal” është realizuar 1 projekt. Mjetet e planifikuar për investime kapitale kanë qenë në vlerë prej 50,000.00 €, dhe është shpenzuar vlera totale prej 50,000.00 € ose 100%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:
- Marrëveshja për mbështetje financiare është nënshkruar me datë 24.02.2025.

- Zotimi i mjeteve është bërë më 04.07.2025, për shkak të zbatimit të ligjit me Nr. 08/L-332 mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2025 konkretisht neni 14 - Shpenzimet e paparashikuara dhe rezervat.

Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese sipas Nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

- ❖ Nga programi “Mbështetja për projektet infrastrukturore për komunitete në Komunitet e Republikës së Kosovës” është realizuar 1 projekt. Mjetet e planifikuar për investime kapitale kanë qenë në vlerë prej 100,000.00 €, dhe është shpenzuar vlera totale prej 100,000.00 €, ose 100%, bazuar në procedurat e implementimit si në vijim:
- Marrëveshja për mbështetje financiare është nënshkruar me datë 24.02.2025.
- Zotimi i mjeteve është bërë me datën 04.07.2025.

Marrëveshja për mbështetje financiare ka përcaktuar obligimet e palëve nënshkruese, sipas nenit të Marrëveshjes - obligimet e komunave, këto të fundit obligohen të zhvillojnë procedurat e prokurimit sipas legjislacionit në fuqi.

Veprimi - 2.1.3 Pasqyrimi sipas rajoneve zhvillimore të resurseve natyrore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Pasqyrimi i resurseve natyrore sipas rajoneve zhvillimore, është realizuar nga stafi i DPAR, dhe është publikuar dokumenti në faqe të ministrisë, si dhe është shtyp në kopje fizike.

- Pasqyrimi i Resurseve Natyrore sipas Rajoneve Zhvillimore - Fauna
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/FA807387-7A00-46C9-BDCF-EAB50768CC5F.pdf>
- Pasqyrimi i Resurseve Natyrore sipas Rajoneve Zhvillimore - Flora
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/B31F7525-2C27-4DA4-8CB3-A39C920B8BFA.pdf>

Objektivi Specifik: 2.2 - Reduktimi i pabarazive përmes ndihmës financiare të balancuar në sektorin privat dhe publik;

Veprimi - 2.2.1 Analiza e investimeve kapitale sipas rajoneve zhvillimore;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale - DPAR, ka realizuar me sukses çdo vit Analizën e Investimeve Kapitale sipas Rajoneve Zhvillimore, duke avancuar çdo vit me analiza. Analiza e vitit 2024 dhe 2025 përfshin gjithë buxhetin shtetëror të planifikuar dhe të realizuar si nga niveli qendror ashtu edhe nga niveli lokal, të dedikuar për investime kapitale. Analizat sipas viteve, janë të publikuara në faqe të ministrisë.

- Analiza e Investimeve Kapitale Sipas Rajoneve Zhvillimore
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/5836FABD-8298-4C0B-A1D9-90D0D254CBA9.pdf>

Veprimi - 2.2.2 Analiza e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajone; (Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MFPT, MZHR)

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale - DPAR, ka realizuar me sukses çdo vit Analizën e shpërndarjes së granteve në sektorin privat nga niveli qendror në rajonet zhvillimore. Analizat e realizuara janë të publikuara në faqe të ministrisë sipas viteve.

Veprimi - 2.2.3 Hartimi dhe Implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Gjatë vitit 2025, është realizuar hartimi dhe implementimi i programit të zhvillimit rajonal me grante për komuna për përmirësimin e infrastrukturës publike.


Me datë 26.02.2025, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027, në kuadër të të cilit është paraparë Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale. Në funksion të implementimit të kësaj mase, më 27.03.2025 është publikuar thirrja publike për aplikim nga komunat.

Si rezultat i këtij procesi, janë përzgjedhur gjithsej 16 projekte të reja, prej të cilave 6 projekte njëvjeçare dhe 10 projekte dyvjeçare. Paralelisht, gjatë vitit 2025 ka vazhduar implementimi i projekteve të bartura nga viti 2024.

Vlera e përgjithshme financiare e projekteve të zbatuara gjatë vitit 2025, bazuar në Memorandumet e Mirëkuptimit, ka arritur në 3,799,333.36 euro.

Projektet janë implementuar në të shtatë rajonet zhvillimore, duke kontribuar në përmirësimin e infrastrukturës publike dhe zhvillimin e balancuar territorial.

Shpërndarja e mjeteve financiare sipas rajoneve zhvillimore është paraqitur në grafikun në vijim:



Shpërndarja e mjeteve financiare pasqyron mbështetjen e komunave në të gjitha rajonet zhvillimore, në përputhje me prioritetet e identifikuara për zhvillim rajonal të balancuar.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=101417>

- Njoftim për komunat lidhur me lansimin e thirrjes "Programi për Zhvillim Rajonal PZHR 2025" (Investime kapitale)
<https://mzhr.rks-gov.net/postime/njoftim-per-komunat-lidhur-me-lansimin-e-thirrjes-programi-per-zhvillim-rajonal-pzhr-2025-investime-kapitale/>
- Raporti i zbatimit të Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale për vitin 2025
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/838DC68B-AB0F-4DD3-B892-517A5E9B9823.pdf>

Veprimi - 2.2.4 Hartimi dhe Implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat;


(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Gjatë vitit 2025, është realizuar hartimi dhe implementimi i programit për zhvillim rajonal të balancuar me grante në sektorin privat.

Me datë 26.02.2025, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027, në kuadër të të cilit është paraparë Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla. Kjo masë përbëhet nga tri Nën Masa: mbështetje për veprimtaritë zejtare, për start-up dhe ide të reja biznesore si dhe për bizneset ekzistuese.

Në funksion të implementimit të programit, gjatë vitit 2025 janë lansuar thirrjet publike për përfituesit në kuadër të Nën Masave përkatëse.

Në kuadër të Nën Masës 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare, janë përzgjedhur gjithsej 19 përfitues, me një vlerë totale financimi prej 45,215.92 euro. Bashkëfinancimi nga përfituesit ka qenë minimal, në vlerë prej 81.60 euro. Si rezultat i zbatimit të projekteve janë krijuar 17 vende të reja pune. Projektet janë përqendruar kryesisht në rajonet zhvillimore Qendër dhe Veri, ndërsa rajonet tjera kanë pasur përfaqësim më të kufizuar.



Në kuadër të Nën Masës 2.3: Mbështetje për bizneset ekzistuese, janë përzgjedhur gjithsej 78 përfitues, me një vlerë totale financimi prej 1,394,060.71 euro, ndërsa bashkëfinancimi nga përfituesit arrin në 411,053.33 euro. Projektet janë shpërndarë në të gjitha rajonet zhvillimore, duke reflektuar mbulim të gjerë territorial.

Në kuadër të kësaj Nën Mase, shpërndarja e përfituesve sipas rajoneve zhvillimore është si vijon:

1. Rajoni zhvillimor 01 – Qendër: 13 projekte
2. Rajoni zhvillimor 02 – Veri: 8 projekte
3. Rajoni zhvillimor 03 – Perëndim: 8 projekte
4. Rajoni zhvillimor 04 – Jug: 18 projekte
5. Rajoni zhvillimor 05 – Jug-Lindje: 8 projekte
6. Rajoni zhvillimor 06 – Lindje: 8 projekte
7. Rajoni zhvillimor 07 – Jug-Perëndim: 15 projekte

Kjo nën-masë është ende në fazën e implementimit.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=101417>

- Thirrje publike: PZHRB 2025 – Mbështetje financiare për Ndërmarrjet Mikro dhe të Vogla dhe Veprimtarit Zeytare.

<https://mzhr.rks-gov.net/postime/ministria-e-zhvillimit-rajonal-lanson-skemen-e-granteve-programi-i-zhvillimit-rajonal-te-balansuar-2025-per-veprimtarite-e-bizneseve-mikro-zejtare-manifakture-artizanale-inovative/>

- Raporti i zbatimit të Masës 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zeytare për vitin 2025

<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/4.-Raporti-i-zbatimit-te-Nen-Mases-2.1.-Zejta-ret-2025.pdf>

- Thirrje publike: Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2025 Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla

<https://mzhr.rks-gov.net/postime/ministria-e-zhvillimit-rajonal-lanson-skemen-e-granteve-programi-i-zhvillimit-rajonal-te-balansuar-2025/>

Objektiv Specifik: 2.3 - Promovimi i politikave zhvillimore që ndikojnë në rritjen e zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar;

Veprimi - 2.3.1 Plani i veprimit 2026-2028 (Strategjia për zhvillim rajonal 2020-2030)

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

Është themeluar grupi punues për hartimin e Planit të ri të veprimit 2026-2028, janë mbajtur 2 takime, 1 puntori dy-ditore si dhe 1 puntori gjysmë-ditore, ku nga Grupi punues janë marrë të gjitha komnetet dhe janë inkorporuar në Plan të veprimit ku si Draft-final është finalizuar nga Grupi punues. Gjatë vitit 2026 pritet të hartohet ky Plan edhe në Qeveri.

Veprimi -2.3.1.1 Hartimi i udhërrëfyesit për qasje në fonde strukturore të BE-së;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Ky dokument shpjegues synon të sqarojë se si Bashkimi Evropian (BE) i qaset formulimit dhe zbatimit të politikave të zhvillimit të balancuar rajonal. Ai përqendrohet në procesin e formulimit të politikave, përcaktimin e objektivave strategjikë, prioritetet e zhvillimit, programet mbështetëse dhe mekanizmat e shpërndarjes së fondeve, me qëllim promovimin e zhvillimit të barabartë ekonomik dhe social midis rajoneve.

Dokumenti u hartua dhe u publikua në faqen e internetit të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në dhjetor 2025.

- Dokumenti Për Qasje Në Fondet e Bahskimit Evropian 2025

<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/E102AD48-4BD1-4B70-B35C-721B87A17A42.pdf>

Veprimi - 2.3.2 Zhvillimi i programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MINT)

Gjatë vitit 2025, është realizuar zhvillimi i Programit për promovimin e politikave zhvillimore të rajoneve socio-ekonomike, përmes hartimit dhe miratimit të Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027.

Me datë 26.02.2025, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027, i cili përfaqëson instrumentin kryesor të politikave të zhvillimit rajonal në vend. Programi është i strukturuar në katër masa kryesore:

- Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale
- Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla
- Masa 3: Mbështetje financiare për Qendrat për Zhvillim Rajonal
- Masa 4: Mbështetje financiare për akterët tjerë të zhvillimit socio-ekonomik rajonal

Masa	Nën Masa	Qëllimi	Objektivi	Lidhja me masat e tjera	Përfituesit	Kushtet e përgjithshme
Masa 1: Mbështetje financiare për komunat në investime kapitale	<p>Nën Masa 1.1: Investime në infrastrukturë publike komunale;</p> <p>Nën Masa 1.2: Investime në infrastrukture dhe dixhitalizim;</p> <p>Nën Masa 1.3: Projekte për zhvillim të qëndrueshëm, turizëm dhe trashëgimi kulturore;</p>	<p>Ulja e pabarazisë mes komunave dhe rajoneve zhvillimore përmes përmirësimit të infrastrukturës socio-ekonomike, eliminimit të mungesës së stimujve për nxitjen e ndërmarrjeve, dhe ulja e migrimit të brendshëm të rinjve dhe bizneseve nga rajonet më pak të zhvilluara drejt qendrave më të mëdha. Kjo masë synon të mbështesë ekosistemin për zhvillim të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës përmes</p>	<p>1. Përmirësimi i infrastrukturës socio-ekonomike dhe dixhitalizimi i proceseve në rajonet më pak të zhvilluara, për të krijuar kushte më të mira jetese dhe zhvillimi ekonomik.</p> <p>2. Përmirësimi i infrastrukturës socio-ekonomike dhe dixhitale në rajonet më pak të zhvilluara, për të krijuar kushte më të mira jetese dhe zhvillimi ekonomik.</p>	<p>Kjo masë ndërlidhet me masat që synojnë përmirësimin e kapaciteteve rajonale duke krijuar një bazë të fortë për zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës në rajonet zhvillimore.</p>	<p>Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.</p> <p>Institucionet lokale, përfshirë Qendrat për Zhvillim Rajonal dhe institucionet e tjera në nivel lokal.</p> <p>Organizatrat e Shoqërisë Civile dhe organizatat private që operojnë në fushën e zhvillimit socio-ekonomik, dixhital, turizmit</p>	<p>Komunat dhe përfituesit e tjerë potencialë duhet të dorëzojnë projekt-propozime që janë në përputhje me prioritetet e programit vjetor. Shpërndarja e fondeve do të bazohet në vlerësimin e potencialit rajonal dhe nevojave të përfituesve.</p>

		politikave publike efektive.			dhe trashëgimisë kulturore.	
Masa 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla	Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare; Nën Masa 2.2: Mbështetje për Start-Up dhe ide të reja biznesore; Nën Masa 2.3: Mbështetje për bizneset ekzistuese.	Qëllimi i kësaj mase është të mbështesë zhvillimin ekonomik rajonal përmes ofrimit të mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, duke kontribuar në uljen e pabarazive ndërmjet komunave dhe rajoneve. Kjo masë synon të krijojë stimuj për nxitjen e ndërmarrjeve të reja, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, të mbështesë veprimtaritë zejtare dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore, si dhe të ndihmojë bizneset ekzistuese në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese, promovimin e eksporteve dhe reduktimin e varësisë nga importet.	1. Mbështetja e zhvillimit të qëndrueshëm përmes promovimit të aktiviteteve tradicionale dhe zejtare, duke ruajtur trashëgiminë kulturore dhe duke e përshtatur atë me nevojat moderne. 2. Nxitja e inovacionit dhe ndërmarrjeve të reja përmes ofrimit të mbështetjes për Start-Up, veçanërisht për të rinjtë dhe gratë, duke përmirësuar mundësitë e punësimit dhe zhvillimit ekonomik. 3. Rritja e kapaciteteve të bizneseve ekzistuese për të përmirësuar performancën ekonomike, për të zvogëluar importet dhe për të forcuar eksportet, duke kontribuar në zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.	Kjo masë lidhet me programet për zhvillim rajonal të balancuar, duke mbështetur ndërmarrjet që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik të komunave dhe rajoneve dhe që përmirësojnë kushtet socio-ekonomike në Kosovë.	Ndërmarrjet mikro dhe të vogla në të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Start-Up dhe ide të reja biznesore që përfshijnë të rinjtë dhe gratë. Organizatrat dhe palët tjera të interesuara që janë aktive në sektorin ekonomik dhe të inovacionit.	Aplikantët, përfshirë ndërmarrjet ekzistuese dhe idetë e reja biznesore, duhet të dorëzojnë propozime që përmbushin kriteret ligjore dhe janë në përputhje me prioritetet e programit. Shpërndarja e fondeve do të bazohet në vlerësimin e kapacitetit të biznesit dhe potencialit të rritjes ekonomike.
Masa 3: Mbështetje financiare për Qendrat Zhvillim Rajonal	Nën Masa 3.1: Sigurimi i mbështetjes teknike dhe financiare për në zhvillimin zbatimin e politikave balancuara rajonale. Nën Masa 3.2: Kordinimi dhe zbatimi i planeve operacionale rajonale. Nën Masa 3.3: Rritja e kapaciteteve të	Qëllimi i kësaj Mase është të mbështesë zhvillimin dhe forcimin e kapaciteteve të Qendrave për Zhvillim Rajonal (QZHR) në Kosovë për të krijuar një koordinim më të mirë ndërmjet rajoneve, për të siguruar një zhvillim të barabartë dhe për të zbatuar projekte që forcojnë ekuilibrin midis zonave urbane dhe rurale.	1. Përmirësimi i kapaciteteve të QZHR-ve për të zhvilluar dhe zbatuar politika rajonale të qëndrueshme dhe të koordinuara me prioritetet e zhvillimit të Kosovës. 2. Zbatimi i planeve operative për zhvillimin rajonal që promovojnë një zhvillim të ekuilibruar mes zonave urbane dhe rurale, duke mbështetur gjithashtu investimet socio-ekonomike dhe dixhitale.	Kjo masë lidhet ngushtë me masat që synojnë zhvillimin e infrastrukturës socio-ekonomike dhe dixhitale (Masa 1), dhe mbështetjen e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (Masa 2). QZHR-të do të luajnë një rol kyç në koordinimin e përpjekjeve rajonale për të siguruar që	Qendrat e Zhvillimit Rajonal të krijuara sipas Ligjit për Zhvillimin Rajonal dhe rregulloreve përkatëse.	Përshtatshmëria për çdo Qendër të Zhvillimit Rajonal e krijuar përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit ndër komunale.

	Qendrave për Zhvillim Rajonal.		3. Rritja e aftësive teknike dhe menaxheriale të QZHR-ve për të identifikuar dhe zbatuar projekte që përmirësojnë zhvillimin rajonal dhe bashkëpunimin ndërkomunal.	zhvillimi të jetë gjithëpërfshirës dhe i balancuar midis komunave dhe rajoneve.		
Masa 4: Mbështetje financiare për aktorët tjerë të zhvillim socio-ekonomik rajonal	Nën Masa 4.1.: Mbështetje për Organizata e Shoqërisë Civile; Nën Masa 4.2.: Mbështetje për Institucionet e arsimit të lartë dhe institucionet kërkimore - shkencore Nën Masa 4.3.: Mbështetje për organizatat specializuara Nën Masa 4.4.: Bashkëpunimi me donatorët	Qëllimi i kësaj Mase është të mbështesë aktorët e ndryshëm që kontribuojnë në zhvillimin socio-ekonomik rajonal përmes ofrimit të mbështetjes financiare dhe teknike për projekte të fokusuara në zhvillimin e qëndrueshëm, përfshirjen sociale, kërkimin dhe inovacionin. Kjo masë synon të rrisë bashkëpunimin ndërmjet sektorëve të ndryshëm dhe të forcojë kapacitetet e organizatave dhe institucioneve që veprojnë në nivel lokal dhe rajonal.	1. Rritja e përfshirjes sociale dhe përmirësimi i kapaciteteve të grupeve të marginalizuara përmes mbështetjes së projekteve të shoqërisë civile që synojnë zhvillimin socio-ekonomik dhe promovimin e barazisë. 2. Nxitja e inovacionit dhe kërkimit shkencor në nivel rajonal përmes mbështetjes së projekteve që kontribuojnë në zhvillimin teknologjik, përmirësimin e arsimit dhe avancimin e aftësive në sektorë të ndryshëm. 3. Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet organizatave, institucioneve dhe donatorëve për të siguruar zbatimin efikas të projekteve që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve socio-ekonomike të rajoneve në zhvillim.	Masa 4 lidhet me Masat 1, 2 dhe 3 duke ndihmuar në koordinimin dhe zbatimin e projekteve që promovojnë zhvillimin e qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës në nivel rajonal. Kjo masë plotëson përpjekjet për të përmirësuar infrastrukturën dhe kapacitetet e komunave dhe ndërmarrjeve, duke angazhuar aktorët tjerë për të kontribuar në zhvillimin e rajoneve.	Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC). Institucionet e arsimit të lartë dhe Institucionet kërkimore-shkencore. Organizatata e specializuara që veprojnë në sektorin e zhvillimit rajonal. Donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë që janë të përfshirë në projekte të zhvillimit të qëndrueshëm.	Subjektet e pranueshme duhet të dorëzojnë projekt-propozime që janë në përputhje me objektivat e Programit për Zhvillim Rajonal të Balancuar. Projektet duhet të kenë një ndikim të qartë në zhvillimin socio-ekonomik të rajoneve dhe të përfshijnë mekanizma për monitorim dhe raportim të rezultateve. Financimi do të shpërndahet në bazë të nevojave specifike dhe kapaciteteve të përfituesve për të zbatuar projektet në mënyrë të suksesshme.

Struktura e programit pasqyron një qasje të integruar të politikave zhvillimore rajonale, duke siguruar koordinim ndërmjet ndërhyrjeve në infrastrukturë publike, zhvillim ekonomik privat, forcim institucional dhe përfshirje të aktorëve tjerë socio-ekonomik.

Programi synon promovimin e zhvillimit të balancuar rajonal, uljen e pabarazive ndërmjet rajoneve dhe komunave si dhe rritjen e ndikimit të politikave publike në zhvillimin socio-ekonomik të qëndrueshëm.

Programi është në fazë të implementimit dhe monitorohet në mënyrë të vazhdueshme përmes mekanizmave institucional të raportimit dhe vlerësimit të rezultateve.

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=101417>

Objektivi Specifik: 2.4 - Zgjerimi i bashkëpunimit ndër-rajonat përmes programeve trans nacionale;

Veprimi -2.4.1 Përgatitja e plan programit për anëtarësim dhe kërkesa për anëtarësim ne programet: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, MPJD)

Gjatë pjesëmarrjes së përfaqësuesve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në konferencën: “Agroturizmi Mesdhetar si Mjet për Turizmin dhe Zhvillimin Lokal dhe Regjional në Komunitetet EUSAIR” Bari, Itali - 29.09.2025-30.09.2025, patëm mundësi ti takojmë veç e veç sekretariatet e programeve Adrion, Danub dhe Euro-med, me të cilet u diskutua rreth mundësisë që të ardhmen Kosova të jetë pjesë e programeve në fjalë, dhe mobilizimin e faktorëve që ndikojnë ne përafrimin e Kosovës deri ne anëtarësimin plotë ne programet e lartcekura.

Veprimi -2.4.2. Përgatitja e planit të bashkëpunimit me sekretariatet e programeve trans nacionale: BALKANMED, ADRION dhe DANUB;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ZKM)

MZHR merr pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Programit Interreg Evropë në Arnhem, Holandë - 05.06.2025-06.06.2025;

Pjesëmarrja e përfaqësuesve të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal në konferencën: “Agroturizmi Mesdhetar si Mjet për Turizmin dhe Zhvillimin Lokal dhe Regjional në Komunitetet EUSAIR” Bari, Itali - 29.09.2025-30.09.2025;

MZHR merr pjesë në punëtorinë e organizuar nga Programi ndërkufitar (CBC)Shqipëri - Kosovë me dt.03.06.2025;

MZHR merr pjesë në punëtorinë dy ditore programi ndër-kufitar Kosovë -Mali i Zi 12-14 Dhjetor 2025;

OBJEKTIVI STRATEGJIK: 3. ZHVILLIMI I QËNDRUESHËM RAJONAL BAZUAR NË RESURSE NATYRORE, EKONOMIKE, KULTURORE DHE HUMANE

Objektivi specifik- 3.1 - Inventarizimi i resurseve, natyrore, ekonomike, kulturore dhe humane të qëndrueshme dhe te promovuara;

Veprimi - 3.1.2. Krijimi i data bazës për identifikimin e burimeve njerëzorë sipas profileve profesionale sipas rajoneve zhvillimore.

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR, ASK, MFPT, MASHT)

Departamenti për Performancë dhe Analiza Rajonale, ka hartuar pasqyrimin e resurseve ekonomike, natyrore, kulturore dhe humane, të gjitha janë shtypur në kopje fizike dhe janë publikuar në faqe të ministrisë. Për hartimin e këtyre dokumenteve gjitha të dhënat janë marrë nga ministritë e linjes dhe gjatë përpunimit të të dhënave janë konsultuar institucionet përkatëse për verifikimin final të të dhënave.

- Dokument Pasqyrimi i Resurseve Humane Ne Rajone Zhvillimore – Humane <https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/Pasqyrimi-i-Resurseve-Humane-ne-Rajonet-Zhvillimore.pdf>
- Dokument Pasqyrimi i Resurseve Kulturore Ne Rajone Zhvillimore - Kulturore <https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/61a6284b-6499-431a-9ac7-c2b9680e631a.pdf>

Objektivi Specifik: 3.2 Ndërtimi i kapaciteteve për shfrytëzimin e të gjitha resurseve

Veprimi - 3.2.2 Ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal për shfrytëzimin e resurseve natyrore, përmes përkrahjes financiare;

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Gjatë vitit 2025, është realizuar ngritja e kapaciteteve humane të nivelit lokal përmes përkrahjes financiare të organizatave të shoqërisë civile, me fokus në zhvillimin socio-ekonomik dhe shfrytëzimin e potencialeve lokale në nivel rajonal.

Me datë 26.02.2025, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar Programin për Zhvillim Rajonal të Balancuar 2025–2027, në kuadër të të cilit është paraparë Masa 4: Mbështetje financiare për akterët tjerë të zhvillimit socio-ekonomik rajonal. Kjo masë përfshin mbështetjen e organizatave të shoqërisë civile, institucioneve akademike dhe kërkimore, organizatave të specializuara si dhe bashkëpunimin me donatorët.


Në kuadër të Nën Masës 4.1, Ministria e Zhvillimit Rajonal ka mbështetur 54 Organizata të Shoqërisë Civile në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës, me një fond total prej 242,820.00 euro. Projektet e financuara janë të orientuara në ngritjen e kapaciteteve lokale, zhvillimin e aftësive të të rinjve dhe grave, promovimin e ndërmarrësisë, zhvillimin e turizmit si dhe fuqizimin e bashkëpunimit ndërkomunal dhe ekonomik.

Emri i OJQ-së	Titulli i projektit	Rajoni Zhvillimor	Σ e ndarë nga MZHR	Kohëzgjatja e projektit
Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Lindje	Zhvillimi i kapaciteteve lokale për menaxhimin e subvencioneve për NVM në rajonin Lindje	06 - Lindje	9,940.00	6 muaj
Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Perëndim	Mbështetja e strukturave ndërkomunale për zbatimin e politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar	03 - Perëndim	9,980.00	6 muaj
Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Jug	Studimi i promovimit të politikave rajonale duke përfshirë përdorimin e teknologjisë	04 - Jug	9,100.00	6 muaj
Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Veri	Promovimi i zhvillimit të balancuar rajonal përmes aktivizimit ekonomik dhe komunat në rajonin Veri	02 - Veri	10,000.00	6 muaj
Agjencia për Zhvillim Rajonal – AZHR Qendër	Forcimi i kapaciteteve rajonale për një ekonomi të qëndrueshme	01 - Qendër	10,000.00	6 muaj
Activism Roots	Zhvillimi i kapaciteteve të të rinjëve lokal për zhvillim dhe mundësi të reja ekonomike	07 - Jug-perëndim	7,500.00	3 muaj
Equality	Tehnolosko osnazivanje zena: IT za zene - put ka zaposlenju	04 - Jug	3,500.00	4 muaj

Rona	Ekoturizmi për zhvillim rajonal - Hulumtimi i aftësive që mungojnë në turizëm	04 - Jug	6,000.00	4 muaj
Bonevet - Kaçanik	Fuqizimi i vajzave dhe të rinjëve në zonat rurale përmes teknologjisë dhe aftësive të buta	05 - Jug-lindje	3,000.00	5 muaj
AGF 'Feminae'	Fuqizimi i grave sipërmarrëse për zhvillim ekonomik	04 - Jug	6,000.00	2 muaj
Start UP (SuP)	Inkurajimi i të rinjëve dhe grave në sektorin e dizajnit dhe marketingut	01 - Qendër	3,000.00	3 muaj
Kosovo Experts Group - KOEG	Fuqizimi i grave në biznes përmes konsulencës dhe panairit	02 - Veri	6,000.00	4 muaj
Sakuntala	Rinia e komuniteteve rome, ashkali dhe egjiptjan për mundësi ekonomike	04 - Jug	2,500.00	2 muaj
OMNES	Forumi rajonal i zhvillimit dhe aktivizimit qytetar	02 - Veri	6,000.00	5 muaj
People First	E ardhmja fillon këtu	01 - Qendër	3,000.00	3 muaj
Tourism and Marketing Institute - TMI	Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio ekonomik rajonal përmes turizmit dhe rritja e bashkëpunimit ndërkomunal	03 - Perëndim	5,000.00	2 muaj
ESNAF	Fuqizimi rinor për zhvillim në tregun e punës	04 - Jug	2,100.00	4 muaj
Instituti për Ekonominë e Tregut të Lirë - IETL	Ndërlidhja e politikave lokale dhe rajonale për ekonominë kreative në Kosovë	01 - Qendër	6,000.00	3 muaj
GLV Natyra	Promovimi dhe fuqizimi i bashkëpunimit ndërmjet komunave, bizneseve dhe investitorëve potencial	05 - Jug-lindje	6,500.00	3 muaj
Frojdi	Zhvillimi i aftësive sociale dhe strategjive të marketingut	01 - Qendër	3,500.00	2 muaj
Youth Association for Human Rights	Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio ekonomik rajonal në komunat e: Suharekës, Lipjanit dhe Shtimes	01 - Qendër	5,000.00	4 muaj
Retina	Promovimi dhe zgjerimi i zhvillimit socio ekonomik rajonal	01 - Qendër	6,000.00	4 muaj
Politeia	Komunat e zhvilluara, rajon i qëndrueshëm ekonomik	06 - Lindje	6,000.00	4 muaj
D&D Business Support Center	Zhvillimi dhe promovimi i bizneseve përmes panairit	01 - Qendër	5,600.00	3 muaj
Ardhmëria Jonë - AJ	Identifikimi dhe promovimi i mundësive të bashkëpunimit ndërmjet bizneseve me qëllim të zhvillimit socio ekonomik rajonal të balancuar	01 - Qendër	4,500.00	3 muaj
Smart Inovation Centre	Trajnime për gratë në zhvillimin rajonal në ndërmarrësi të qëndrueshme	02 - Veri	5,500.00	2 muaj
Instituti për Fuqizim dhe Pjesëmarrje të Rinisë - IFPR	Avancimi dhe fuqizimi i të rinjëve në tregun e punës	02 - Veri	3,000.00	5 muaj
Instituti për Hulumti dhe Politika Zhvillimore POLIS	Përmirësimi i ekonomisë dhe mjedisit përmes politikave të gjelbërta	02 - Veri	6,000.00	5 muaj
Vizioni Rinor i Shalës	Youth in tech	01 - Qendër	3,000.00	3 muaj
Qendra për Edukim, Inovacion dhe Zhvillim Profesional - AKADEMIA	Fuqizo kreativitetin tënd	05 - Jug-lindje	3,000.00	2 muaj
Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale - KLGJ	Partneriteti rajonal për zhvillim të qëndrueshëm	01 - Qendër	6,500.00	5 muaj

WELLE	Punësohu përmes TIKUT	01 - Qendër	2,800.00	3 muaj
Instituti për Zhvillim dhe Integrim - IZHI	Forcimi i ekonomisë lokale përmes bashkëpunimit dhe promovimit	06 - Lindje	5,000.00	4 muaj
Progresi dhe Avancimi Rinor në Kosovë - PARKS	Potenciali rinor	05 - Jug-lindje	2,100.00	1 muaj
Pontis / Ura	Nxitja e inovacionit dhe zhvillimit profesional për gratë dhe të rinjtë	01 - Qendër	3,000.00	4 muaj
Sarski Behar	Lideri sutransnjice: Razvoj mekih vestina za mlade	04 - Jug	2,100.00	2 muaj
Center for Developm. Community - Millenium - CDCM	Aftësimi përmes edukimit joformal të të rinjëve si potencial të zhvillimit socio ekonomik rajonal - Lipjan	01 - Qendër	3,000.00	4 muaj
Kosova Turkiye Mezunlari Dernegi - TUMED	Udhëtim zhvillimor me fuqië psikologjike të sipërmarrësve të rinjë	04 - Jug	6,000.00	5 muaj
Leadership Develop. Association Albania LDA	Agjenda e gjelbërt në veprim	05 - Jug-lindje	6,000.00	3 muaj
Future Development Centre - FDC	Promovimi i bashkëpunimit ndërmjet bizneseve të grave dhe komunave	02 - Veri	4,500.00	4 muaj
DKCG	Deciji Kulturri Centar	01 - Qendër	2,100.00	2 muaj
Shoqata 'Fuqizimi i gruas dhe rinisë - FGRS'	Fuqizimi i grave dhe të rinjëve përmes trajnimeve në ndërmarrësi në komunat Suharekë dhe Rahovec	04 - Jug	2,100.00	3 muaj
Nomad Kosova	Shtigjet që bashkojnë - turizëm ndërkomunal Skenderaj - Zubin Potok	02 - Veri	2,100.00	4 muaj
Perspektiva Energjetike	Promovimi i prodhimeve të energjisë elektrike - Prosumet dhe agjenda e gjelbërt në zhvillimin socio ekonomik të balancuar në Kosovë	01 - Qendër	5,000.00	5 muaj
Our youth our future - RJAJ	Hapësira që flet: Hartimi i guidës turistike për Mitrovicën dhe rrethinën	02 - Veri	2,100.00	4 muaj
Instituti për Integritet Publik	Praktika pjesëmarrëse për transformim pozitiv: Gratë dhe të rinjtë për zhvillim të balancuar rajonal	01 - Qendër	2,100.00	5 muaj
Shoqata "Jeto Shëndetshëm:	Avancimi i zhvillimit socio-ekonomik dhe ndërmarrësisë në rajonin e Jugut - Prizren	04 - Jug	2,100.00	2 muaj
SDBC	Ekonomsko osnaživanje preduzenika sa centralno dela Kosova	01 - Qendër	2,200.00	2 muaj
Idetë e reja Ekonomike	Zhvillimi i aftësive të buta, si: lidhshipi, komunikimi efektiv, hulumtimi dhe zhvillimi i ideve kreative	02 - Veri	2,100.00	5 muaj
Global Development Solutions - GLOBEDS	Partneriteti i suksesit - për ndërmarrësi të rinjë socio-ekonomik	04 - Jug	2,100.00	5 muaj
Rinia Aktive e Prizrenit	Nxitja dhe vetëdijësimi i të rinjëve të komunitetit turk dhe boshnjak në kuadër të zhvillimit socio ekonomik në Prizren	04 - Jug	2,100.00	3 muaj
Forumi Shqiptar për Kulturë & Trashëgimi Kulturorë - FSHKTK	Forcimi i Lidhshipit për një Zhvillim të Qëndrueshëm Rural	04 - Jug	3,500.00	5 muaj
Florg	Roli i sektorit privat në ekonominë vendore dhe partneriteti me bizneset	04 - Jug	2,500.00	2 muaj
KULTUS	KULLË TECH	07 - Jug-perëndim	3,500.00	4 muaj
Gjithsej:			242,820.00	

Analiza e shpërndarjes së përfituesve sipas rajoneve zhvillimore tregon përfshirje të gjerë territoriale, ku rajoni zhvillimor: 01 - Qendër ka pjesëmarrjen më të lartë, i ndjekur nga rajoni zhvillimor 04 - Jug dhe 02 - Veri, ndërsa rajonet tjera zhvillimore kanë nivel më të ulët të përfaqësimit.



<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=101417>

<https://mzhr.rks-gov.net/postime/mzhr-lanson-thirrjen-publike-per-mbeshtetje-financiare-te-projekteve-programeve-te-ojq-ve-ne-avancimin-e-zhvillimit-socio-ekonomik-rajonal-te-balancuar-per-vitin-2025/>

- Raporti i zbatimit të projekteve përfituese të Masës 4, Nën Masa 4.1. Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile, 2025
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/832918EF-45F6-44D6-86C3-C5FA78302523.pdf>

- Rajoni Zhvillimor Qendër

AZHR-Qendër vazhdimisht ka mbështetur të gjitha Komunitetet e rajonit qendër, si dhe organizatat tjera të shoqërisë civile në procesin e zhvillimit të projekteve për zhvillim ekonomik të balancuar në rajonin qendër. Ofrimi i shërbimeve të rregullta për mbështetjen e investimeve për investitorët në rajonin qendër.

AZHR Qendër ka vazhduar angazhimin e saj të drejtpërdrejtë me komunitetet anëtare në identifikimin dhe adresimin e sfidave që lidhen me zhvillimin e kapaciteteve lokale dhe rajonale, me qëllim krijimin e një ambienti më të favorshëm për zhvillimin e ndërmarrësisë dhe avancimin e zhvillimit rajonal.

Në kuadër të kësaj, janë organizuar dhe zhvilluar një sërë tryezash të rrumbullakëta dhe aktivitete promovuese, të cilat kanë shërbyer si platformë për diskutim ndërmjet akterëve lokalë, institucioneve dhe palëve të interesit.

Si rezultat i mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme në planifikimin strategjik dhe zhvillimin e politikave të mirëfillta zhvillimore, komunat e Rajonit Qendër janë përballur me vështirësi në shfrytëzimin e mundësive për financim dhe qasje në fonde të ndryshme zhvillimore.

Kjo situatë është evidentuar edhe përmes diskutimeve të zhvilluara në kuadër të aktiviteteve të AZHR Qendër, ku autoritetet komunale kanë ngritur si shqetësim kryesor mungesën e kapaciteteve profesionale në hartimin dhe zbatimin e strategjive për zhvillimin ekonomik dhe ndërmarrësinë.

AZHR Qendër ka reflektuar në dizajnimin e ndërhyrjeve të saj, duke orientuar aktivitetet drejt fuqizimit të kapaciteteve komunale në planifikim strategjik, rritjes së bashkëpunimit ndërkomunal dhe promovimit të një qasjeje më të koordinuar dhe gjithëpërfshirëse për zhvillimin rajonal.

- Rajoni Zhvillimor Lindje

AZHR Lindje ka vazhduar të ofroj përkrahje direkte 11 komunave të rajonit Lindje dhe Juglindje përfshirë të gjithë të interesuarit për aplikim për grante në kuadër të thirrjeve të MZHR-së për Programin për Zhvillim Rajonal të Balansuar 2025-2027 (Thirrja për biznese dhe Investime kapitale).

Si rezultat gjatë vitit 2025 janë përzgjedh dhe financuar 7 projekte të investimeve kapitale në rajonin Lindje dhe Juglindje.

Sa i përket sektorit privat gjatë vitit 2025 rreth 100 biznese dhe aplikant potencial kanë marre asistencë në lidhje me kriteret dhe mënyrën e aplikimit ndërsa gjithsej 15 biznese kanë qenë përfituese nga thirrja e MZHR për PZHRB 2025 dhe thirrja për veprimtarite e bizneseve mikro Zejtare/Manufakturë, Artizanale dhe Inovative. AZHR Lindje u ka ofruar asistencë këtyre përfituesve lidhur me implementimin e suksesshëm të projekteve.

Agjencia ka realizuar me sukses projektin “Zhvillimi i kapaciteteve lokale për menagjimin e subvencioneve për NMV në rajonin Lindje”, financuar nga Ministria e Zhvillimi Rajonal.

Ky projekt ka pas për qëllim të avancoj dhe promovoj zhvillimin socio-ekonomik të balansuar në rajonin ekonomik Lindje dhe Juglindje me fokus të veçant në përkrahjen e zhvillimit dhe ngritjes së kapaciteteve lokale/rajonale dhe në masat që ndikojnë në krijimin e një ambienti më të favorshëm për investime.

Në kuadër të këtij projekti janë ngritur kapacitetet e 19 zyrtareve komunal nga rajoni Lindje dhe Juglindje të cilët kanë ndjekur punëtorinë dy-ditore e cila kishte për qëllim forcimin e kapaciteteve lokale dhe rajonale për menaxhimin e subvencioneve për mbështetje të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla si katalizator i zhvillimit ekonomik lokal, rritje të punësimit dhe krijimin e një mjedisi më të favorshëm për investime dhe zhvillim të qëndrueshëm në rajonin përkatës.

Komunat kanë marre asistencë profesionale dhe teknike gjatë realizimit të aktiviteteve të tyre individuale si panairë (Komuna Gjilan është përkrahur për organizimin e panairit “Forco Traditën” ku kanë marre pjesë 30 biznese nga rajoni Lindje, Qendër dhe Jug), përgatitje të materialeve për promovim të turizmit, strategji lokale etj.

AZHR Lindje gjatë vitit 2025 ka vazhduar me përkrahjen edhe të OJQ dhe individëve për aplikim në thirrje të ndryshme për OJQ, MBPZHR etj. Janë përkrahur më se 10 individë dhe

OJQ në përgatitjen e projekt propozimeve si dhe dokumentacioneve të nevojshme teknike për aplikim.

- Rajoni Zhvillimor Perëndim

Gjatë vitit 2025, AZHR-Perëndim si pjesë e aktiviteteve të projekti “Mbështetja e strukturave ndër-komunale për zbatimin e politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar”, të financuar nga ana e MZHR, ka realizuar në bashkëpunim me MZHR punëtori me tri Grupe Punuese Tematike të cilat kanë punuar në identifikimin e fushave prioritare zhvillimore për një periudhë afat-mesme tre deri pesë vjeçare. Këto tri grupe punuese kanë përfshirë zyrtar të drejtorive të ndryshme komunale nga gjashtë komunat e rajoneve perëndim dhe jugperëndim të emëruar në: i) Grupi Punues për Zhvillim Ekonomik, Ndërmarrësi dhe Turizëm të Qëndrueshëm, ii) Grupi Punues për Infrastrukturë dhe Shërbime Komunale, dhe iii) Grupi Punues për Mbrojtje dhe Promovim të Trashëgimi Kulturore dhe Natyrore. Përtej punës me grupe punuese, aktivitetet e projektit kanë përfshirë edhe organizimin e një tryezë të rrumbullakët, ku janë përfshirë Kryetarët e Komunave, drejtoritë përkatëse dhe udhëheqës nga MZHR, nën koordinimin e AZHR-Perëndim. Përmes këtij takimi është diskutuar dhe arritur pajtim lidhur me modalitet e funksionimit të procesit koordinues në mes MZHR-së dhe Komunave në rajonet perëndim dhe jugperëndim, duke përfshirë e funksionimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në këto dy rajone, duke proceduar për miratim Marrëveshjet e reja të Bashkëpunimit Ndër-komunal.

1. Siç është cekur më lartë, gjatë vitit 2025 AZHR-Perëndim si pjesë projekti “Mbështetja e strukturave ndër-komunale për zbatimin e politikave të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar”, të financuar nga ana e MZHR, ka realizuar në bashkëpunim me MZHR punëtori me tri Grupe Punuese Tematike të cilat kanë punuar në identifikimin e fushave prioritare zhvillimore për një periudhë afat-mesme tre deri pesë vjeçare. Pas përfundimit të këtyre aktiviteteve me grupe punuese, është organizuar një tryezë të rrumbullakët, ku janë përfshirë Kryetarët e Komunave, drejtoritë përkatëse dhe udhëheqës nga MZHR, nën koordinimin e AZHR-Perëndim. Përmes këtij takimi është diskutuar dhe arritur pajtim lidhur me modalitet e funksionimit të procesit koordinues në mes MZHR-së dhe Komunave në rajonet perëndim dhe jugperëndim, duke përfshirë e funksionimin e Qendrave për Zhvillim Rajonal në këto dy rajone, duke proceduar për miratim Marrëveshjet e reja të Bashkëpunimit Ndër-komunal.

2. Gjatë vitit 2025, AZHR-Perëndim ka përfunduar me sukses zbatimin e projektit “Shndrimi i fshatrave tona në destinacione turistike” të financuar nga BE-ja përmes programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar Kosovë-Mali i Zi, ku së bashku me Komunës e Pejës dhe partnerë nga Mali i Zi kanë zbatuar aktivitete për zhvillimin e turizmit rural në këtë rajon. AZHR-Perëndim gjatë vitit 2025 ka punuar me partnerë në zhvillimin e tre projekt propozimeve të reja për programin e lartë cekur të BE-së, si pjesë e fazës së re të

aplikimit për fonde, dhe është aktualisht në pritje të rezultateve nga ky proces për të vazhduar me zbatimin e projekteve të reja.

- Rajoni Zhvillimor Veri

1. **Funksionimi institucional i AZHR Veri**

AZHR Veri funksionon në bazë të një Marrëveshjeje Mirëkuptimi (MoU) ndërmjet komunave të rajonit Veri, e nënshkruar në vitin 2008. Kjo marrëveshje përbën bazën ligjore dhe institucionale për koordinimin e zhvillimit rajonal në këtë zonë.

2. **Pjesëmarrja e komunave me shumicë serbe**

Komunat me shumicë serbe kanë nënshkruar MoU me AZHR Veri, mirëpo nuk janë aktive për shkak të situatës politike aktuale.

Kjo paraqet sfidë serioze për proceset e ardhshme, veçanërisht në themelimin e Qendrës për Zhvillim Rajonal Veri.

Për këtë arsye, kërkohet një qasje më aktive dhe ndërmjetësuese nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) për të inkurajuar dhe siguruar pjesëmarrjen e tyre aktive.

3. **Promovimi i bashkëpunimit ndërkomunal**

AZHR Veri, në të gjitha takimet me Bordin e saj, promovon në mënyrë aktive bashkëpunimin ndërkomunal si një element kyç për zhvillimin rajonal dhe stabilitetin institucional në rajon.

4. **Mbështetja për qasje në financim (grante)**

AZHR Veri organizon rregullisht sesione informuese për thirrjet e granteve të publikuara nga MZHR, duke rritur kapacitetet e aktorëve lokalë për të aplikuar dhe përfituar nga fondet publike.

5. **Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkufitar**

Në rajonin Veri aktualisht nuk ekziston bashkëpunim ndërkufitar me Serbinë për shkak të situatës politike.

Megjithatë, AZHR Veri bashkëpunon ngushtë me të gjitha komunat dhe organizatat e shoqërisë civile në rajon, duke:

- Organizuar aktivitete të përbashkëta
- Ofruar hapësirë në ambientet e saj pa kompensim
- Mbështetur iniciativat lokale për zhvillim ekonomik dhe social

- Rajoni Zhvillimor Jug

Rezultatet kryesore të AZHR Jug gjatë vitit 2025 kanë qene si ne vijim:

1. Ngritja e kapaciteteve të 40 asambleistëve dhe zyrtarëve të komunes së Prizrenit dhe të komunave tjera të rajonit jug, në kuader të projektit "Autoritete lokale më të forta përmes rritjes së kapaciteteve të përfaqësuesve të kuvendit dhe zyrtarëve komunalë në Prizren dhe komunat përreth", projekt i mbështetur nga zyra e Keshillit Evropian në Kosovë.
Temat e trajtuara gjatë punetorisë dyditore kanë qene Lidërshipi, Qeverisja e Hapur, Demokracia Pjesëmarrëse dhe Deliberative dhe Luftimi i Seksizmit.
2. Edhe gjatë vitit 2025 AZHR Jug dhe Komuna e Prizrenit kanë nënshkruar marrëveshje të mirëkuptimit për organizimin dhe menaxhimin e skemës së granteve për vitin 2025 për mbështetjen e ndërmarrjeve ekzistuese dhe atyre Start-Up në komunën e Prizrenit.
Numri total i aplikacioneve të pranuar ishte 72, me 38 aplikacione në Lot 1 (Start-up) dhe 32 në Lot 2 (Bizneset ekzistuese).
Nga të gjithë aplikantët 22 janë vlerësuar si përfitues potencial (11 në Lot 1 dhe 11 në Lot 2).
Gjithsej vlera e projekteve të financuara bashkë me kontribute vetanake ishte 75,741 EUR.
3. Gjatë këtij viti AZHR Jug i asistoi komunat e rajonit jug gjatë aplikimit në fondet qeveritare, si në MZHR dhe MAPL, poashtu edhe për aplikim në programin e BE-së "CBC Kosovë - Shqiperi".
Gjithashtu, ne zbatim ka projektet e ERPK në Prizren, Malisheve, Suhareke, Rahovec dhe Mamushe.

Veprimi - 3.2.3 Organizimi i trajnimeve për ngritjen e kapaciteteve tek të rinjtë për identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve "start up";

(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Mbështetja financiare e ofruar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR) gjatë vitit 2025 ka mundësuar realizimin e aktiviteteve të fokusuara në organizimin e trajnimeve për të rinjtë për ngritjen e kapaciteteve në identifikimin e mundësive të vetëpunësimit dhe krijimin e bizneseve start-up.

Projektet e financuara në të gjitha rajonet zhvillimore kanë përfshirë trajnime dhe punëtori në fusha si teknologjia informative, ndërmarrësia, marketingu, dizajni, aftësitë e buta dhe zanatet e ndryshme. Si rezultat i këtyre aktiviteteve, janë realizuar dhjetëra trajnime për të rinjtë dhe gratë, janë siguruar certifikime profesionale dhe janë krijuar mundësi për zhvillim të aftësive praktike dhe orientim drejt tregut të punës.

Projektet kanë kontribuar gjithashtu në fuqizimin e përfshirjes sociale, duke përfshirë komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet jo-shumicë, përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe aktivitete zhvillimore që synojnë rritjen e mundësive ekonomike.

Në aspektin e bashkëpunimit dhe zhvillimit lokal, janë organizuar forume, punëtori dhe aktivitete ndërkomunale që kanë kontribuar në forcimin e kapaciteteve të OSHC-ve dhe institucioneve lokale në menaxhimin e projekteve dhe planifikimin zhvillimor.

Gjithashtu, një pjesë e projekteve është fokusuar në teknologji, inovacion dhe ekonomi të gjelbër, përmes trajnimeve në TIK, energji të ripërtëritshme dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme zhvillimore.

Në përgjithësi, mbështetja e MZHR ka kontribuar në ngritjen e kapaciteteve të rinjve për vetëpunësim dhe zhvillim të ideve biznesore, duke krijuar bazë për zhvillimin e iniciativave start-up dhe fuqizimin e potencialit ekonomik lokal.

- Raporti i zbatimit të projekteve përfituese të Masës 4, Nën Masa 4.1. Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile, 2025
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/832918EF-45F6-44D6-86C3-C5FA78302523.pdf>

Objektiv Specifik: 3.3 - Zhvillimi i zonave ekonomike me qëllim të zhvillimit socio-ekonomik rajonal të balancuar

*Veprimi - 3.3.1 Ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike (Investime kapitale) të zonave ekonomike;
(Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)*

Gjatë vitit 2025 është realizuar ndarja e granteve në bashkëpunim me komunat për përmirësimin e infrastrukturës publike në zonat ekonomike, përmes financimit të projekteve kapitale në të gjitha rajonet zhvillimore të Republikës së Kosovës.

Projektet kapitale të financuara nga Ministria e Zhvillimit Rajonal gjatë vitit 2025 kanë përfshirë ndërhyrje në infrastrukturën publike, zhvillimin e hapësirave ekonomike dhe turistike, përmirësimin e rrugëve, tregjeve, objekteve publike si dhe hapësirave rekreative dhe kulturore.

Shpërndarja e investimeve është realizuar në mënyrë të balancuar në të shtatë rajonet zhvillimore të vendit, si në vijim:

Rajoni zhvillimor	Komuna	Emri i projektit	Vlera sipas M.M. (€)	Pjesëmarrja (%)
01 - Qendër	Prishtinë	Sanimi i plotë në Hidroizolim, Termoizolim dhe ndërhyrje në xhama në dy fazat në Pallatin e Rinisë	120,000.00	
	Podujevë	Ndërtimi i tregut të gjelbërt	300,000.00	
	Podujeve	Ndërtimi i sallës së sporteve në fshatin Gllamnik	50,000.00	
Rajoni zhvillimor: 01 - Qendër			470,000.00	12.37
02 - Veri	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Qendrës Multifunksionale 'Omni Sport' në Mitrovicë	150,000.00	
	Mitrovica e Jugut	Renovimi i Stacionit të Autobusëve - Mitrovicë	150,000.00	
	Vushtrri	Udha e Gurit	80,000.00	
	Vushtrri	Rrethoja e Çelikut - Ura e madhe e Sitnicës	100,000.00	
	Zubin Potok	Shëtitorja dhe Parku Rekreativ tek liqeni I Zubin Potokut - Hapësirë për pushim, turizëm dhe komunitet	80,000.00	
Rajoni zhvillimor: 02 - Veri			560,000.00	14.74
03 - Perëndim	Deçan	Zhvillimi i turizmit në komunën e Deçanit - Produktet turistike në fshatin Alpin Bjeshkatore	120,000.00	
	Klinë	Rregullimi i trotuarit dhe shtegut të biçikletave me infrastrukturë përcjellëse nga qyteti i Klinës deri te udhëkryqi Pejë-Prishtinë, faza II	130,000.00	
	Klinë	Ndërtimi i trotuarit me ndriçim Klinë - Jabllanicë dhe Krushevë e Vogël - Zllakuqan	100,000.00	
Rajoni zhvillimor: 03 - Perëndim			350,000.00	9.21
04 - Jug	Prizren	Ndërtimi i objektit administrativ për nevojat e zejtarëve 'ESNAF'	184,160.00	
	Prizren	Zhvillimi i shtigjeve për turizëm, kulturë dhe rekreacion në Kalane e Prizrenit	150,000.00	
	Suharekë	Renovimi i 'Urës së Tranzitit' dhe rregullimi i shtratit të lumit 'Tophulla' - Segmenti 2.2	120,000.00	
	Mamushë	Kërkesë për ndërtimin e shtëpisë së kulturës me shumë qëllime	225,000.00	
	Mamushë	Ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës - Faza II	225,000.00	
	Dragash	Rregullimi i Amfiteatrit të hapur në Bellobrad, ndërtimi i murit mbrojtës në Dragash dhe riparimi i rrugës në Kosavë	130,000.00	

Rajoni zhvillimor: 04 - Jug			1,034,160.00	27.22
05 - Jug-lindje	Ferizaj	Krijimi i infrastrukturës turistike në fshatin Varosh	100,000.00	
	Shtime	Rregullimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes (Faza II)	100,000.00	
	Shtime	Ndërtimi i tregut të hapur në qytetin e Shtimes - faza e III-të	150,000.00	
	Hani i Elezit	Rregullimi i hapësirave turistike në Han të Elezit dhe fshatrat: Pustenic, Krivenik, Seçishtë, Paldenicë, Gorancë	90,121.95	
Rajoni zhvillimor: 05 - Jug-lindje			440,121.95	11.58
06 - Lindje	Gjilan	Rregullimi i parqeve dhe hapësirave publike në zonën urbane të qytetit	219,569.32	
	Novobërdë	Ndërtimi i rrugës Dragancë e re dhe Dragancë e vjetër	97,482.09	
	Kllokot	Rregullimi i shtratit të lumit Morava e Vjetër në Kllokot	120,000.00	
	Kamenicë	Parku i Aventurave	50,000.00	
	Partesh	Rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Budrig të Parteshit	100,000.00	
Rajoni zhvillimor: 06 - Lindje			587,051.41	15.45
07 - Jug-perëndim	Gjakovë	Renovimi i objektit të NPL "Stacionit të Autobusëve" - Gjakovë	100,000.00	
	Rahovec	Ndërtimi i Ballkonit Panoramik mbi qytetin e Rahovecit	70,000.00	
	Rahovec	Ndërtimi i parkingjeve të reja me ndriçim publik, hapësira të gjelbëruara dhe ndërtimi i rrugës në lagjen e Komuniteteve	98,000.00	
	Junik	Përmirësimi i infrastrukturës lokale për rritjen e potencialit turistik - Komuna e Junikut	90,000.00	
➤ Rajoni zhvillimor: 07 - Jug-perëndim			➤ 358,000.00	➤ 9.42
Totali i përgjithshëm:			3,799,333.36	100.00

Vlera totale e projekteve të financuara në kuadër të këtij veprimi arrin në 3,799,333.36 euro, duke reflektuar një mbulim të gjerë territorial dhe bashkëpunim të drejtpërdrejtë me komunat për identifikimin dhe implementimin e projekteve prioritare të infrastrukturës publike.

Analiza e shpërndarjes rajonale tregon një përqendrim më të lartë të investimeve në rajonin zhvillimor 04 - Jug dhe 02 - Veri, ndërsa rajonet tjera kanë përfituar në mënyrë të qëndrueshme sipas nevojave dhe prioriteteve lokale.

- Raporti i zbatimit të projekteve përfituese të Masës 4, Nën Masa 4.1. Mbështetje për Organizatat e Shoqërisë Civile, 2025
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/02/838DC68B-AB0F-4DD3-B892-517A5E9B9823.pdf>

Veprimi - 3.3.2 Ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike me theks të veçantë për zhvillim socio-ekonomik rajonal të balancuar (Institucionet përgjegjëse sipas Strategjisë për zhvillim Rajonal: MZHR)

Gjatë vitit 2025 është realizuar ndarja e granteve për rritjen e kapaciteteve prodhuese të bizneseve në zonat ekonomike, me fokus në zhvillimin socio-ekonomik të balancuar në të gjitha rajonet zhvillimore të Kosovës.

Në kuadër të Nën Masës 2.1 Mbështetje për veprimtaritë zeytare, janë përkrahur 19 biznese përfituese, të cilat kanë përfituar mbështetje financiare për zhvillimin dhe zgjerimin e veprimtarive të tyre në sektorët e shërbimeve, prodhimit dhe tregtisë. Projektet janë zbatuar në shtatë rajonet zhvillimore, me fokus të veçantë në mbështetjen e ndërmarrjeve të vogla dhe nxitjen e vetëpunësimit.

Rajoni Zhvillimor	Nr. i projekteve	Shuma e financuar nga MZHR (€)	Spektori
01 - Qendër	5	11,654.50	Shërbime
01 - Qendër	1	1,910.00	Shërbime
02 - Veri	5	12,330.70	Shërbime
02 - Veri	1	2,500.00	Prodhim
03 - Perëndim	1	2,450.00	Prodhim
04 - Jug	5	12,420.72	Shërbime
06 - Lindje	1	1,950.00	Prodhim

Nga implementimi i këtyre projekteve janë krijuar gjithsej 17 vende pune, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e kapaciteteve prodhuese dhe fuqizimin ekonomik lokal.

Në kuadër të Nën Masës 2.3 Mbështetje për bizneset ekzistuese, projektet janë në fazën e implementimit dhe pritet të kontribuojnë më tej në rritjen e kapaciteteve të bizneseve ekzistuese dhe zgjerimin e aktivitetit ekonomik në nivel rajonal. Të dhënat përfundimtare për këtë Nën Masë do të përfshihen në raportin vijues pas përmbylljes së ciklit të implementimit.

- Raporti i zbatimit të Masës 2: Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro dhe të vogla, Nën Masa 2.1: Mbështetje për veprimtaritë zejtare për vitin 2025
<https://mzhr.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/04/4.-Raporti-i-zbatimit-te-Nen-Mases-2.1.-Zejtaret-2025.pdf>

VLERËSIM I PËRGJITHSHËM LIDHUR ME TË ARRITURAT DHE REZULTATET PËR IMPLEMENTIM TË STRATEGJISË PËR ZHVILLIM RAJONAL PËR VITIN 2025

Sfidat e implementimit gjatë vitit 2025 kanë qenë:

- Aprovimi i drafteve të 4 Rregulloreve të cilat derivojnë nga Ligji për Zhvillim Rajonal;
- Situata politike gjatë vitit 2025;
- Zbatimi i tri programeve zhvillimore të MZHR-së për vitin 2025 ku kërkohet edhe angazhim tjetër në kuadër të punëve dhe detyrave që dalin nga Divizionet përkatëse në kuadër të Departamentit për Planifikim dhe Koordinim të Zhvillimit Rajonal.
- DPAR/MZHR, koordinimi i aktiviteteve me akterët relevant dhe mbledhja e të dhënave.
- Kapacitete humane apo numër i vogël i stafit.

AKTIVITETE DHE SFIDAT TE GRUPIT PUNUES RRETH MONITORIMIN E STRATEGJISE PER ZHVILLIM RAJONAL PËR VITIN 2025

- Sipas planit të veprimit, Grupi Punues ka qenë në komunikim të vazhdueshëm me institucionet përgjegjëse, duke organizuar takime dhe duke hartuar raporte në baza periodike për arritjen e objektivave të strategjisë.
- Grupi Punues ka pranuar raporte në kohë nga të gjitha institucionet me të cilat bashkëpunon për hartimin e Raportit Vjetor mbi Zbatimin e Strategjisë së Zhvillimit Rajonal për vitin 2025.
- Një nga sfidat e Grupit Punues ka qenë ndryshimi i anëtarëve të grupit gjatë vitit 2025.